REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:262701

Datë: 07.07.2020

Numri i dokumentit: 01011941

P. nr.649/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti,** me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarës G.SH. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 181 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë PP.nr.1371/19 të dt.06.11.2019, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më **datë 06.07.2020,** në prani të Prokurorit të shtetit Enis Gashi , te dëmtuarit F.SH. mbrojtësit te akuzuarës s av. Blerina Kurtaj , si dhe te akuzuarës G.SH. të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli ,këtë:

A K T GJ Y K I M

E akuzuara **G.SH., e bija e H.,** dhe e nënës H., e gjinisë S.,data e lindjes... K Gjakovë , tani jeton ne Gjakovë, ka te kryer shkollën fillore , e pa punë -amvise, e gjendjes së dobët ekonomike-shfrytëzuese e ndihmave sociale , shqiptare ,shtetase e R. Kosovës, e divorcuar , nënë e 2 fëmijëve, me ID....

Ë s h t ë f a j t o r e

Sepse :

- **me dt.15.10.2019 , rreth orës 13.30 min në Gjakovë,** përmes telefonit me nr .045...,e kanos seriozisht të dëmtuarin F.SH ,përkatësisht ish bashkëshortin e saj ,në atë mënyrë që pas mos marrëveshjes paraprake që kishin i dëmtuari me të pandehurën rreth një dhome të cilën e mbante të mbyllur me çelës ,ashtu që e njëjta në shenjë revolte i dërgon mesazhe kërcënuese me fjalë "**veç edhe niher mthirr dikush per qat dhom pot betona ne alla e nqita femije, mos jav gjujsha bumet es mjav hup farën tanve shka kam mju maru une juve** "

-me çka ka kryer veprën penale të kanosjes nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4, 7, 17 par.1, 38 , 46,47,48,49,69, 70, dhe nenit 181 par.1 të KPRK-ës dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarës i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej **3(tre)muaj** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimin në afatin prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien ne barrën e mjeteve buxhetore

2019:262702

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1371/19 të dt.06.11.2019, e ka akuzuar të akuzuarën G.SH nga Gjakova, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 181/1 të KPRK-së, duke propozuar që ndaj të akuzuarës ti shqiptohet Urdhër ndëshkimor, me të cilën do ti shqiptohet dënimi me gjobë. Gjykata ka aprovuar Propozimin e Prokurorisë Themelore dhe me Aktgjykim me P.nr.649/19 të dt.04.02.2020, të akuzuarën e ka shpallur përgjegjëse dhe e ka dënuar me gjobë ne shume prej nga 200 ,oo.-Euro , si dhe i ka obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30,oo euro. E akuzuara G.SH në afatin ligjor ka parashtruar kundërshtim kundër këtij Aktgjykimi me dt. 14.02.2020 dhe për këtë arsye pranë kësaj Gjykate u mbajt shqyrtimi gjyqësor.

Përfaqësuesi i PTH-DP në Gjakovë, Prokurori Enis Gashi , në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 06.07.2020 , lexon aktakuzën PP.nr.1371/19 të datës 06.11.2019 , me ç 'rast prokurori deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.. Ne fjalën përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë nga e akuzuara e që u bë i lirshëm e vullnetshëm duke i kuptuar pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë u vërtetu mjaftë edhe pse nga shkresat e lendes ka edhe prova tjera bindëse se ka kryer veprën penale kanosjes nga neni 181/1 të KPRK-ës , e gjykatës i propozoi qe te njëjtin ta shpall fajtor për shkallen e përgjegjësisë penale te ta dënoi sipas ligjit dhe ta detyroi ne pagesën e shpenzimeve te procedurës.

E akuzuara G.SH , gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 06.07.2020 , lidhur me fajësinë deklaroi se pas konsultimit të mjaftueshme me mbrojtësin e saj av, Blerina Kurtaj , deklaroi se pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet, duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion. Ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer në afekt për çka i kërkojë falje nga i dëmtuari , premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me e kujdesshëm, andaj i propozoi gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,gjendjen e dobët ekonomike nënë e dy fëmijëve të mitur e qe jetojmë me ndihma sociale , te me shqiptohet një dënim me i butë.

I dëmtuari F.SH.në fjalën përfundimtare deklaroi se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkojë kompensim dëmi .

Pasi gjykata ka fituar bindjen se e akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza ,ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPPK-së, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese gjykata konsideron faktin se e akuzuara ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarës se është nënë – vetë ushqyese e dy fëmijëve të mitur , është shfrytëzueses e ndihmave sociale , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga e akuzuara, sjelljen korrekte në gjykim, pendimin e shprehur për veprën e kryer , premtimin se në të ardhmen do te jetë më e kujdesshme , deklarata e të dëmtuarit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi , të cilat rrethana ndikuan që Gjykata të akuzuarës i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet

2019:262702

nëse e akuzuara brenda afatit prej 1(një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale , me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 38 dhe47 të KPRK-së, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe se ky sanksion do të ndikoj tek e akuzuara që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata nuk ka vendosur për kërkesë pasurore juridike ngase ti dëmtuari F.SH. gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike .

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri ne mbështetje te nenit 453/4 të KPP-ës , pasi që e akuzuara është e gjendjes së dobët ekonomike ,shfrytëzuese e ndihmave sociale e detyrimi qe ti paguajnë shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale te akuzuarve ose të personave që detyrohen ti mbështesin materialisht.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P.nr.649/19 më datë 06.07.2020.

Sekretarja juridike, **Gj y q t a r j a,**
Flutur Nagavci **Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

2019:262702